

Deloitte.



Deloitte Audit Albania shpk

Raporti i Transparencës

Viti Financiar 2017

● Audit

RAPORTI I TRANSPARENÇES SË DELOITTE AUDIT ALBANIA sh.p.k.

Hyrje

Si një firmë auditimi që kryen auditimin ligjor të llogarive vjetore të entiteteve me interes publik, *Deloitte Audit Albania sh.p.k* ("Shoqëria") publikon raportin vjetor të transparencës në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009 ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, datë 28 prill 2016 "*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*" lidhur me auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore dhe të pasqyrave financiare të konsoliduara vjetore.

Gjithë informacioni i dhënë në këtë raport lidhet me situatën e Shoqërisë Deloitte Audit Albania sh.p.k më 31 dhjetor 2017, përveç se kur citohet ndryshe.

1. Rrjeti Deloitte

Rreth Deloitte

"Deloitte" është markë nën të cilin dhjetëra mijëra profesionistë të përkushtuar nga firma të pavarura në mbarë botën bashkëpunojnë për të siguruar auditim, konsultim, këshillim financiar, menaxhim risku, shërbime ligjore dhe taksash për klientët e përzgjedhur. Këto firma janë anëtare të Deloitte Touche Tohmatsu Limited ("DTTL"), një Shoqëri e themeluar në Mbretërinë e Bashkuar, me përgjegjësi të kufizuar me garanci. Çdo firmë anëtare ofron shërbimet në një zonë të caktuar gjeografike dhe i nënshtrohet ligjeve dhe rregullave profesionale të vendit të caktuar ose të vendeve në të cilat ajo operon. DTTL nuk ofron në mënyrë direkte shërbime për klientët. DTTL si dhe firmat anëtare të DTTL janë entitete të ndara në aspektin ligjor dhe të dallueshme nga njëra-tjetra, të cilat nuk mund të influencojnë subjektet e tjera. DTTL dhe çdo firmë anëtare e DTTL është përgjegjëse vetëm për veprimet apo mosveprimet individuale, dhe jo ato të njëra-tjetrës. Secila nga firmat anëtare vepron sipas emrave "Deloitte", "Deloitte & Touche", "Deloitte Touche Tohmatsu", ose emra të tjerë të ngjashëm. Çdo firmë anëtare e DTTL është e strukturuar në mënyrë të ndryshme në përputhje me ligjet vendase, rregulloret, praktikat zakonore dhe faktorë të tjerë, si dhe mund të sigurojë ofrimin e shërbimeve profesionale në territoret e tyre nëpërmjet degëve, filialeve apo subjekteve të tjera.

Shiko www.deloitte.com/about për një përshkrim të detajuar të strukturës ligjore të Deloitte Touche Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare.

Rreth Deloitte Evropa Qëndrore

Deloitte Evropa Qëndrore ("DEQ") është një organizatë rajonale e subjekteve të organizuara nën kontrollin e Deloitte Central Europe Holdings Limited, firma anëtare në Evropën Qendrore të Deloitte Touche Tohmatsu Limited. Shërbimet ofrohen nga degët dhe filialet e Deloitte Central Europe Holdings Limited, të cilat janë entitete të ndara dhe të pavarura ligjore.

2. Përshkrimi i strukturës ligjore, organizative dhe pronësia e audituesit të regjistruar.

Shoqëria funksionon si një firmë me përgjegjësi të kufizuar. Mbajtësit e kuotave të Deloitte Audit Albania sh.p.k janë:

- | | |
|--|-----|
| • Enida Cara | 51% |
| • Deloitte Central Europe Holdings limited | 49% |

Struktura Qeverisëse:

Bordi i drejtuesve

Deloitte Audit Shqipëri qeveriset nga një bord drejtuesish, i caktuar nga partneret dhe i përbërë nga auditues të autorizuar. Bordi i drejtuesve ruan kompetenca për strategjinë e përgjithshme dhe menaxhimin e përgjithshëm të Deloitte Audit Shqipëri dhe si rrjedhojë, për themelimin e llogarive të saj vjetore. Bordi i drejtuesve mbështetet nga ekipe të specializuara të cilat këshillojnë mbi çështje specifike dhe/ose zbatimin e politikave.

Firmat e autorizuar për auditimin e Deloitte Audit Shqipëri

Firma audituese e autorizuar për të audituar Deloitte Audit Shqipëri është Holly and Endy Auditing sh.p.k. me NUIS: K31323006D.

3. Përshkrimi i strukturës drejtuese të Shoqërisë

Shoqëria drejtohet nga drejtorët dhe partnerët manaxhues. Anëtarët e organeve të drejtimit të Shoqërisë:

- Albana Shahu
- Enida Cara
- Gregory Paul Rossouw

Personat e mësipërm veprojnë edhe si administratorë të Shoqërisë sipas statutit të Shoqërisë në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14 prill 2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Deloitte Audit Albania sh.p.k aktualisht punëson 43 punonjës profesionistë për shërbimet që ofron.

4. Përshkrimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë së Shoqërisë

Shoqëria harton politika dhe procedura për promovimin e një kulture të brendshme të bazuar në njohjen e faktit që cilësia mbetet prioriteti kryesor tek i cili shoqëria mbështetet. Shoqëria fokusohet në përsosmëri profesionale si shtyllë për arritjen e cilësisë maksimale të auditimit në baza vijimësie. Ky sistem përfshin politika dhe procedura që adresojnë përgjegjësitë e udhëheqjes për sistemin e kontrollit të cilësisë brenda Shoqërisë, kërkesat etike, pranimin e klientit, angazhimit dhe vazhdimësisë, burimet njerëzore, performancën e angazhimit dhe monitorimin.

Ky sistem i kontrollit të brendshëm të cilësisë ka dy sisteme monitorimi:

- Rishikimi i kontrollit të cilësisë dhe sigurisë për angazhime dhe
- Rishikimi i praktikës së firmës anëtare

Rishikimi i kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së angazhimit

Raportet e auditimit ligjor mbi llogaritë vjetore ose llogaritë e konsoliduara në lidhje me një entitet me interes publik, ndër të tjera, para lëshimit i nënshtrohen një rishikimi të angazhimit të cilësisë dhe sigurisë nga një partner i Shoqërisë me përvojë të mjaftueshme dhe të përshtatshme profesionale sipas angazhimit përkatës dhe industrisë.

Rishikuesi i kontrollit të cilësisë së angazhimit mund t'i caktohet Shoqërisë nga brenda DEQ për të punuar nën përgjegjësinë e Shoqërisë, por nuk është pjesë e ekipit të angazhimit dhe si rrjedhojë nuk portretizohet apo shfaqet si një anëtar i ekipit.

Rishikuesi informohet në mënyrën e duhur nga ekipi i angazhimit dhe kryen rishikimin në mënyrë të tillë që të përftohet një kuptimësi e mjaftueshme për të arritur në përfundime. Përgjegjësia e rishikuesit është kryerja e një shqyrtimi objektiv të auditimit, kontabilitetit, dhe çështjeve të raportimit financiar, për të dokumentuar procedurat e kryera nga ai, dhe për të konkluduar, bazuar në të gjitha faktet e rëndësishme dhe rrethanat nga të cilat rishikuesi ka dijeni, se nuk ka çështje të sjellë në vëmendjen e tij e cila do t'a bënte atë të besojë se gjykimet e rëndësishme dhe përfundimet e arritura nuk ishin të përshtatshme për rrethanat. Për angazhimet e identifikuara me rrezikshmëri më të lartë, caktohet një partner i veçantë rishikimi për të siguruar një nivel shtesë të kompetencës dhe objektivitetit në planifikimin dhe kryerjen e angazhimit. Partneri i veçantë i rishikimit mund t'i caktohet Shoqërisë nga brenda DEQ për të punuar nën përgjegjësinë e Shoqërisë, por është i pavarur nga angazhimi. Normalisht ky partner zotëron aftësi teknike dhe specialitet mbi industrinë, të zbatueshme në angazhim si dhe, në situata të caktuara, është i pavarur nga njësia e praktikës në mënyrë që të tejkalohet objektiviteti apo të sigurohen burime të specializuara. Raporti i auditimit mund të lëshohet vetëm nëse rishikuesi është i kënaqur nga gjykimet dhe konkluzionet e ekipit të angazhimit të auditimit, dhe kur këto konkluzione janë në pajtueshmëri me standardet dhe rregulloret në fuqi.

Rishikimi i Praktikës

Shoqëria është subjekt i një shqyrtimi të sigurimit të cilësisë, ose "rishikimit të praktikës", siç zakonisht i referohet, intervaleve që nuk i kalojnë tre vjet. Normalisht, performanca e çdo partneri të auditimit vlerësohet gjatë ciklit trevjeçar, dhe së paku një angazhim për secilin partner përzgjedhet për të arritur këtë qëllim. Konsideratë po ashtu i është dhënë edhe vlerësimi të performancës së menaxherëve, veçanërisht atyre të cilët janë kandidatë për emërimin partner.

4. Përshkrimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë së Shoqërisë (vazhdim)

Shoqëria është përgjegjëse për shqyrtimin e praktikës. DEQ jep udhëzime dhe mbikëqyrje në lidhje me planin e rishikimit të praktikës dhe procedurave. Koordinimi i përgjithshëm dhe administrimi i programit të rishikimit të praktikës është përgjegjësi e drejtorit të këtij procesi.

Plani i rishikimit të praktikës, procesi dhe rezultatet janë riparë dhe janë pajtuar nga një partner i një tjetër firme anëtare ("partneri konkurrent,"), çdo vit. Partneri konkurrent, të cilit i është caktuar kjo përgjegjësi, punon ngushtë me drejtorin e rishikimit të praktikës në mbikëqyrjen e planifikimit dhe performancën e rishikimit.

Llojet e angazhimeve të rishikuara

Angazhimet e përzgjedhura për rishikim përfshijnë angazhime kombëtare si dhe ato ndërkombëtare (auditimi i pasqyrave financiare që janë ose mund të përdoren përtej kufijve kombëtarë), duke përfshirë njësitë ekonomike me interes publik, si dhe një numër të angazhimeve të auditimit me risk të lartë. Disa angazhime të ndjeshme dhe komplekse (p.sh, angazhime të vitit të parë, situata ku ka një ndryshim në kontroll, apo përqendrim të gjendjes financiare) janë po ashtu të përzgjedhura si dhe të gjitha industritë e mëdha nga ana tjetër.

Fusha e Rishikimit të Praktikës

Caktimi i rishikuesve është i bazuar në nivelin e aftësive, njohurive mbi industrinë, si dhe eksperiencës në angazhime ndërkombëtare.

Shqyrtimet e angazhimeve individuale konsistojnë në diskutime me partnerin dhe/ose menaxherin përgjegjës për angazhimin dhe rishikimin e raporteve të lidhura, letrave të punës dhe, sipas rastit, dokumentave korrespondues.

- Angazhimet rishikohen për të:
- Përcaktuar nëse procedurat e kontrollit të cilësisë janë zbatuar siç duhet për angazhime të tilla,
- Vlerësuar aftësinë e zbatimit të qasjes së auditimit, duke përfshirë përputhshmërinë me politikën dhe procedurat e Shoqërisë që gjenden në manualin e politikave,
- Kontrolluar pajtueshmërinë me ligjet e aplikueshme lokale, si dhe
- Vlerësuar cilësinë e përgjithshme të shërbimit të ofruar për klientët.

Menaxhimi i rrezikut dhe politikave e procedurave të kontrollit të cilësisë të zyrave të praktikës brenda Shoqërisë po ashtu janë rishikuar, duke përfshirë si vijon:

- Programin e menaxhimit të rrezikut, duke përfshirë klientin, pranueshmërinë dhe vijimësinë e angazhimit
- Pavarësinë
- Rekrutimin dhe avancimin
- Zhvillimin profesional
- Paraqitjen publike në vendet e tjera
- Rishikimet e specializuara mbi teknologjinë e informacionit
- Konsultimin me ekspertë të Shoqërisë
- Konsultimin me ekspertë të jashtëm
- Përfshirjen e rishikimeve të kontrollit të cilësisë

4. Përshkrimi i sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë së Shoqërisë (vazhdim)

Gjetjet dhe rekomandimet që rezultojnë nga rishikimet praktike janë të përfshira në planin e cilësisë së auditimit të Shoqërisë dhe i paraqiten udhëheqjes së Shoqërisë dhe DEQ. Qëllimi i planit të cilësisë së auditimit është ofrimi i sugjerimeve për përmirësim në përgjigje të gjetjeve të vërejtura. Shoqëria adreson gjetjet përmes kryerjes së një analize rrënjësore dhe hartimit të një plani të detajuar që përcakton veprimet që do të merren, personin(at) përgjegjës, dhe kohën për të zbatuar rekomandimet, ku është e aplikueshme.

Përveç kësaj, Shoqëria komunikon me partnerin përkatës dhe personelin tjetër të mundshëm mbi mangësitë e vëna në dukje (nëse ka) si rezultat i rishikimit të praktikës dhe rekomandimeve për ndërmarrjen e veprimeve të duhura korrigjuese. Shoqëria gjithashtu komunikon rezultatet e rishikimit të praktikës dhe konsideratën e vazhdueshme dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të cilësisë tek partnerët si dhe personat të tjera përgjegjës.

Deklarata e Menaxhimit

Grupi menaxherial i Shoqërisë është pozitiv kur sistemi i kontrollit të brendshëm, siç përshkruhet më sipër, është efektiv në ofrimin e një sigurie të arsyeshme se firma e auditimit dhe personeli i saj janë në përputhje me standardet e aplikueshme profesionale dhe kërkesat rregullatore dhe ligjore dhe se raportet e auditimit të lëshuara janë të përshtatshme për rrethanat .

5. Data e fundit e rishikimit të pavarur të kontrollit të cilësisë ka qënë në tetor 2016, nga ku Shoqëria ka marrë vlerësimin më të lartë.

6. Lista e subjekteve të interesit publik audituar gjatë vitit të fundit financiar

Lista e subjekteve të interesit publik audituar gjatë vitit të fundit financiar paraqiten në tabelën më poshtë vijon:

Shtojca 1 – ENTITETET ME INTERES PUBLIK NE 2017	
Raiffeisen Bank sh.a.	Bankë
Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.	Bankë
Tirana Bank sh.a.	Bankë
Union Bank sh.a.	Bankë
Raiffeisen Leasing sh.a.	Jo- Bankë, Qira Financiare
Tirana Leasing sh.a.	Jo- Bankë, Qira Financiare
Landeslease sh.a.	Jo- Bankë, Qira Financiare
Albania Leasing sh.a.	Jo- Bankë, Qira Financiare
Raiffeisen Invest sh.a.	Fond Menaxhimi
Paylink sh.a.	Institucion Financiar Jo-bankar
Pay and go sh.p.k.	Institucion Financiar Jo-bankar

7. Konfirmimi i Pavarësisë

DEQ ruan politika dhe procedura të shkruara mbi pavarësinë, të cilat përfshijnë edhe kryerjen e disa kontrolleve të pajtueshmërisë së pavarësisë në baza vjetore dhe të cilat janë të aplikueshme për Kompaninë si pjesë e DEQ.

- Çdo profesionist duhet të nënshkruajë një konfirmim individual mbi pavarësinë, vit pas viti. Përveç kësaj, konfirmime të kësaj natyre mbi pavarësisë janë përshtatur për punonjësit e rinj si dhe ato të larguar nga Shoqëria.
- I gjithë stafi menaxherial dhe të tjerët e lartpërmendur duhet të përfshijnë interesat e tyre financiare në një sistem global të monitorimit të pavarësisë. Portofoli i çdo personi kontrollohet kundrejt një liste elektronike të klientëve të auditit për të parë nëse kjo pronësi është e lejuar sipas rregullave përkatëse të pavarësisë;

-

7. Konfirmimi i Pavarësisë (vazhdim)

- Të gjithë profesionistët duhet të plotësojnë një test elektronik nëpërmjet intranetit mbi rregullat e pavarësisë dhe;
- Klienti dhe Proceset e pranueshmërisë së angazhimit janë përdorur për të vërtetuar që pavarësia nuk humbet vlerë.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm të pajtueshmërisë me politikat e pavarësisë, inspektime të pavarësisë dhe procedura të testimit kryhen çdo vit mbi një target të profesionistëve dhe zyrtarëve të lartë.

Një konfirmim i brendshëm mbi pajtueshmërinë e pavarësisë nga punonjësit e Shoqërisë është kryer më qershor 2017 si dhe një testim i brendshëm i kësaj pajtueshmërie dhe inspektim mbi punonjësit e zgjedhur është finalizuar më qershor 2017.

8. Edukim i vazhdueshëm

Të gjithë audituesit e Shoqërisë azhurnojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre teknike dhe profesionale nëpërmjet kurseve të shumta që ofrohen nga vetë Shoqëria si dhe nga kurse apo trajnime që organizohen jashtë Shoqërisë nga organe profesionale të akredituara

Edukimi i vazhdueshëm është një politikë kyçe e Shoqërisë, pasi ky është një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e njohurive, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve tona. Deloitte Learning intranet ofron një pikënisje, përfshirë trajnim teknik (GAAP, GAAS, rregullat profesionale, taksa, IT), menaxhimin dhe aftësitë e të punuarit me të tjerë, kurse biznesi, ekonomiku dhe për industri specifike.

I gjithë stafi kërkohet që të marrë pjesë në mësimin mbi Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, legjislacionin fiskal dhe rregulloret tregtare të zbatueshme. Trajnimet vjetore të përditësimit të njohurive në fushën e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar janë të detyrueshme për të gjithë stafin profesional të auditimit.

Programi i edukimit të vazhdueshëm është i përbërë nga sesione trajnimi të organizuara nga Deloitte si dhe trajnime të jashtme. Disa kurse janë të detyrueshme dhe të tjerë janë fakultativë, kështu që çdo Auditues ose Trajnues mund të personalizojë programin e tij të mëimit.

Gjatë viteve të para, pjesa më e madhe e trajnimit përbëhet nga kurse të detyrueshme mbi tema teknike duke përfshirë metodologjinë dhe proceset e Deloitte, por më pas pjesa fakultative rritet, meqë nevojat individuale bëhen më të larmishme. Nje program individual mësimi është i nevojshme nga niveli senior 2 (afërsisht 4 vjet eksperiencë).

Audituesit me më shumë përvojë pritet të rinovojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre teknike. Zhvillimi i dhe aftësitë ndërpersonale dhe menaxheriale janë gjithashtu shumë të rëndësishme për këtë grup. Ekziston edhe mundësia për të ndjekur arsimin afatgjatë, të tilla si programet e MBA. Ekziston edhe një sistem i akreditimit ku një kurs trajnimi duhet të përmbushet përpara një Audituesi duke kryer detyra të caktuara.

Përmes një sistemi të automatizuar të monitorimit është e mundur të kontrollohet statusi i kurseve të brendshme dhe të jashtme të ndjekur nga një Auditues individual. Edukimi i vazhdueshëm është gjithashtu një faktor që merret parasysh për vlerësimin vjetor të stafit të auditimit dhe vlerësimin e potencialit të rritjes në kuadër të Shoqërisë.

9. Informacioni Financiar

Angazhimet	Honoraret e Faturuara
A- Angazhimi ligjor i Auditit	56,270,316
A1- Angazhime të tjera të Auditit	23,406,735
A2- Angazhime të tjera të Sigurise	-
A3- Angazhime të Rishikimit	-
A4- Angazhime të tjera	-
Totali	79,677,051

10. Shpërblimi i Partnerëve

Partnerët vlerësohen në baza vjetore dhe në varësi të rezultatit të vlerësimit shpërblimi i ortakëve mund të rritet ose ulet. Vlerësimi i Partnerëve merr parasysh faktorët e mëposhtëm: cilësi, ekspertizë, integritet, profesionalizëm, sipërmarrje, pavarësi dhe përputhshmëri.

11. Kërkesa e Licencimit për përputhshmërinë ligjore

Deloitte Audit Albania sh.p.k. është regjistruar në regjistrin publik të ekspertëve kontabël të autorizuar pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël (IEKA) në 31 korrik 2014 me numër license 423.